

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/20, 77/21 dhe 154/23), dhe në lidhje me nenin 141 paragrafi (13) nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencia për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore me ark.nr.1102-743/1 datë 15.02.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.0201-773/7 datë 19.02.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 6-të mbajtur më 19.02.2024, miratoi sa vijon:

**Aktvendim**  
**për paralajmërim publik dhe përjashtim të ritransmetimit të shërbimit programor**

- PUBLIKISHT PARALAJMËROHET** Operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive-operator i rrjetit kabllor INFEL-KTV OHËR SHPK, për shkak të ritransmetimit të shërbimit programor i cili nuk është i regjistruar në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në pajtim me nenin 141 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV).  
Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore me ark.nr.1102-743/1 datë 15.02.2024, që është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.
- URDHËROHET** që Operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive-operator i rrjetit kabllor INFEL-KTV OHËR SHPK, menjëherë pas pranimit të këtij aktvendimi, të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV, pra të ndërpres me ritransmetim të shërbimit programor.
- Të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi ka vepruar sipas aktvendimit për paralajmërim publik dhe për ndërprerje me ritransmetim të shërbimit programor.
- Nëse subjekti i mbikëqyrjes nga pika 1 e këtij vendimi, nuk vepron sipas aktvendimit, pra vazhdon me shkelje për të cilën është paralajmëruar publikisht, Agjencia, në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 2 të LSHMAAV, do të paraqesë kërkesë për iniciimin e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente.
- Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij konsiderohet dita e çertifikimit në arkivin e Agjencisë.

**A r s y e t i m**

Agjencia në pajtim me nenin 6 paragrafi (1) nënparagrafi 4 të LSHMAAV, ndërmerr masa në përputhje me këtë ligj në rastet kur ka shkelje të dispozitave të LSHMAAV ose të rregulloreve miratuara në bazë të tij si dhe të kushteve dhe detyrimeve të lejeve.

Në bazë të nenit 28 të LSHMAAV, Agjencia është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë, si dhe të paketave programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjetet publike të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave të këtij ligji, lejeve, certifikatave të dhëna për regjistrim, aktet nënligjore dhe aktet e tjera të miratuara nga Agjencia.

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, dhe në pajtim me nenin 27 dhe nenin 28 të LSHMAAV, Agjencia më 14.02.2024, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore të paketës programore të ritransmetuar nga operatori Shoqëria Tregtare radiodifuzive-operator i rrjetit kabllor INFEL-KTV OHËR SHPK, nga ku është konstatuar se operatori i cekur, i cili sipas njoftimit nga Agjencia për Komunikim Elektronik mund të kryejë veprimtari në territorin e komunës së Ohrit, për shfrytëzuesit e tij ka ritransmetuar shërbim programor, i cili nuk mbulohet me çertifikatë për regjistrim të shërbimeve programore të dhënë nga Agjencia, e cila është në kundërshtim me nenin 141 të LSHMAAV. Konstatimet nga mbikëqyrja janë të specifikuar në

mënyrë të detajuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.1102-743/1 datë 15.02.2024 , që është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Rrjedhimisht nga sa mësipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 141 paragrafi (13) nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës, Raporti me Shkrim për mbikëqyrje të kryer programore me ark.nr.1102-743/1 datë 15.02.2024 dhe Konkluzionin ark. nr.0201-773/7 datë 19.02.2024 , për shkak të konstatimit për mosrespektim të dispozitave të LSHMAAV të përcaktuara në pikën 1. të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë, miratoi vendim me të cilin ndaj subjektit të lartpërmendur mirret masë paralajmërim publik dhe urdhërohet menjëherë pas pranimit të aktvendimit që të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV, në mënyrë që do të ndërpres me ritransmetim të shërbimit programor.

Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i cekur ka vepruar sipas urdhërit, pra sipas paralajmërimit publik dhe ka ndërprerë me ritransmetim të shërbimit programor.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- Raport me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer programore, ark.nr.1102-743/ 1 datë 15.02.2024.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.